



5 vjet QMBN në Kosovë



Qendra Maqedonase për
Bashkëpunim Ndërkombëtar



5 vjet QMBN në Kosovë

1999-2004



Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

PËRMBAJTJA

Mesazh nga QMBN

5

Kriza kosovare

7

Prezenca e parë e QMBN-së në Kosovë

11

Përkrahje bujqësisë

16

QMBN vazhdoi me programet

19

Forcimi i partnerëve në Kosovë

27

Në Kosovë na mbajnë mend për të mirë

30

4

Të dhëna statistikore

34

Raporti financiar

35

Organizata

36

Kanë thënë për ne

38

Mesazh nga QMBN



Akiviteti i parë në Kosovë i Qendrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) ishte në 28 qershor 1999, duke ofruar ndihmë në Dragash, pas së cilës u hap zyra në Gjakovë më 15 korrik 1999. QMBN në Kosovë? Pse?

Në prill të vitit 1999 në apelin e El Hilalit, QMBN u kyç në ndihmën e personave të zhvendosur në “tokën e askujt” mes Kosovës dhe Maqedonisë. Nga kjo pikë e gjatë gjithë krizës kosovare, QMBN ishte një nga organizatat udhëheqëse në ballafaqimin me pasojat e krizës kosovare për Maqedoninë: refugjatët dhe jostabiliteti politik. Inkuadrimi i tillë i QMBN-së i mundësoi që ta shohë jo vetëm kërcënimin për stabilitetin politik nga numri i madh i refugjatëve, por ta shohë edhe tragjedinë njerëzore në mesin e asaj krize.

Ata nuk ishin refugjatë nga Kosova, por njerëzit, fqinjë tanë në nevojë. Edhe pa dallim të përkatësisë politike ose etnike ose ndonjë përkatësie tejtër, duhet t’u ndihmohet njerëzve, fqinjëve tanë në nevojë.


Ky ishte një vendim i natyrshëm i QMBN-së që t’i ndihmojë fqinjët edhe në vendin e tyre, në Kosovë. Dhe ta ndjekë rolin e tij të “thyesit të akullit” në marrëdhëniet mes dy fqinjve dhe të paragjytimeve të cilat ekzistojnë.

Një organizatë nga Maqedonia ndihmon në Kosovë, me ekipe të përziera nga Maqedonia dhe Kosova, dhe nga maqedonas etnikë dhe shqiptarë etnikë edhe nga Maqedonia edhe nga Kosova. Ekipe të afta të punojnë edhe me kosovarët etnikë shqiptarë dhe joshqiptarët (para së gjithash goranët). Dhe të punojnë në rajonet më së shumti të goditura nga lufta, si Gjakova dhe Krusha e Vogël në Prizren.

Në vitin 2001 duke e ndjekur parimin e vet të zhvillimit të kapaciteteve lokale, prezencën e vet operative e transferoi në partneritet me tri organizata. Dy prej tyre dolën nga ekipet e QMBN-së në Gjakovë: Qendra Zhvillimore Kosovare dhe Iniciativa e Femrës Kosovare.

Në vitet që kaluan mund të dëshmojmë për sakrificën e madhe të shumë njerëzve në përtëritjen e Kosovës, por edhe shumë miqësi në të gjitha nivelet. Jam i sigurtë se shumë nga njerëzit e inkuadruar janë mbështetës të miqësisë së njerëzve nga Maqedonia dhe Kosova. Ky është një kontribut i vogël në paqen dhe stabilitetin, zhvillimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira.

Sasho Klekovski
Drejt看 ekzekutiv



Deklarata për misionin

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) është organizatë e shoqërisë civile që punon në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm, ndërtimin e vetëdijes dhe të ndihmës socio-humanitare (urgjente).

Qëllimi i QMBN-së është nxitja, mbështetja dhe zhvillimi i iniciativave lokale, nacionale dhe ndërkombëtare për avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm të resurseve njerëzore në Maqedoni dhe jashtë saj.

Për realizimin e qëllimeve dhe detyrave QMBN i mobilizon dhe i organizon resurset njerëzore, mjetet financiare dhe materiale, si në vend, ashtu edhe jashtë.

QMBN për aktivitetet siguron mjetet nga më shumë agjenci të Këshillit Botëror të Kishave dhe nga organizatat qeveritare dhe ndërkombëtare.

QËLLIMET, SEKTORËT DHE METODAT

Qëllimet strategjike të QMBN-së janë:

- promovimi i paqes;
- zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë civile;
- ndihma grupeve që kanë nevojë.

QMBN është aktive në këto sketorë:

- furnizimi me ujë dhe sanimi;
- zhvillimi rural;
- arsimi;
- punësimi dhe gjenerimi i të ardhurave;
- shoqëria civile dhe demokratizimi;
- ndihma urgjente.


QMBN aktivitetet i realizon nëpërmjet:

- mbështetjes të projekteve;
- trajnimit dhe këshillimeve;
- informatave;
- përfaqësimit dhe lobimit;
- udhëheqjes.

QMBN është reregjistruar në regjistrin e shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve në Gjykatën themelore – Shkup 1, me numrin e regjistrit 492, me vendim nr. 434/99 nga 06.10.1999. Numri i amzës 4878256. Numri i vetëm i amzës 4030994180119.



➤ Mësimi është i pashmangshëm edhe në kushte të vështira



➤ Vala e parë e refugjatëve në vendkalimin kufitar Bllacë

KRIZA E KOSOVËS

Kriza në Kosovë në vitin 1999 domosdo e kaploi edhe Maqedoninë, e cila pranoi rreth 350.000 refugjatë nga Kosova. Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar qysh para fillimit të krizës në rajon, u përpoq të bëjë parashikime të caktuara, me të cilat e përgatitur do t'u përgjigjet kërkesave dhe nevojave të mundshme të të gjitha subjekteve të inkuadruar në krizë. Por, vala e madhe e refugjatëve i gjeti të papërgatitur jo vetëm organizatat humanitare, por edhe institucionet shtetërore. Në Maqedoni u paraqit frika dhe brengosja nga depërtimi i mundshëm i krizës në vend. Në pajtim me politikën e vet të përgjithshme dhe strategjinë, QMBN reagoi urgjentisht. Nga fundi i marsit të vitit 1999 u përgatit Plani për operacione të emergjencës "Strehimi Maqedonia". Plani filloi që të zbatohet në fillim të prillit në vitin 1999.

Në pajtim me planin u parashikuan më shumë obligime: gatishmëri për aktivitete relevante dhe reale, të cilat do të zbatoheshin në rast të zhvillimit negativ të situatës; mbështetje nevojave themelore të refugjatëve të brengosur në familjet nikoqire dhe kampet; mbështetje grupeve të marginalizuara; forcimi i kapaciteteve njerëzore për njohjen e vlerave dhe prioriteteve të përbashkëta; kontributi në promovimin e stabilitetit nacional dhe mbrojtja e refugjatëve nëpërmjet zvogëlimit të tensioneve ndëretnike mes qytetarëve maqedonas. QMBN reagoi shpejtë ndaj valës së refugjatëve në vendkalimet kufitare. Në javën e parë nga kriza QMBN distribuo i ushqim të mjaftueshëm për 40.000 refugjatë dhe e koordinoi ndihmën e organizatave partnere që arrinte nga vendet e tyre nëpërmjet rrugës ajrore dhe tokësore (Diakonishes Werk nga Gjermania, DanChurch Aid nga Danimarka dhe Norwegian Church Aid nga Norvegjia).

Me pëlqim të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe në pajtim me Komisariatën e Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara, QMBN e ndërmoi udhëheqjen me kampin e refugjatëve në fshatin Radushë. Poashtu, realizoi një sërë aktivitete për zgjidhjen e problemit me furnizim me ujë dhe sanimin në kampet Radushë dhe Bojanë. Poashtu, QMBN e ndërtoi gjithë sistemin sanitar, e organizoi mënjanimin e lëndëve inerte dhe ndërtimin e sistemit dhe drenimit në kampet në afërsi të Çegranit.

Edhe krahas ekzistimit të 14 kampeve të hapura për refugjatë, pjesa më e madhe e tyre (rreth 170.000) ishin vendosur nëpër familjet nikoqire. QMBN siguroi ndihmë për rreth 50.000 shfrytëzues në muaj (në një periudhë prej pesë muajve), prej të cilëve 26.000 refugjatë dhe anëtarë të familjeve nikoqire, duke përfshirë edhe 2.000 foshnja, si dhe 24.000 raste të rrezikuara sociale.



➤ QMBN ndërtoi sistem për ujësjellës në Radushë, Shkup

QMBN arriti të nxisë aksion të përbashkët të organizatave lokale qytetare, që paraqiste vlerë të dyfishtë. OJQ-të lokale ishin “kanali” më i rëndësishëm për mbështetje të refugjatëve. Duke iu falënderuar atyre, siç ishte El Hilali, u siguroa strehim për rreth dy të tretat nga numri i përgjithshëm i refugjatëve. Ndoshta më me rëndësi ishte vendosja e koordinimit të OJQ-ve me qëllim që të sigurohet ndihmë për të gjithë njerëzit, pa dallim të përkatësisë së tyre etnike ose religjioze. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, për shembull, organizata rome “Meseçina” nga Gostivari, u ndihmoi refugjatëve shqiptarëve etnikë, e anasjelltas.



➤ Në vendkalimin kufitar Bllacë (nga e majta) Sasho Klekovski, Kristian Balslev-Olsen, sekretar i përgjithshëm i DCA dhe Pol Nilsen, ministër i atëhershëm i Zhvillimit të Danimarkës



➤ Rreth 170.000 refugjatë u strehuan në familjet nikoqire



➤ Kampi i Çegranit

Organizata të kyçura në shpërndarjen e ndihmës humanitare

Shoqata Humanitare Bamirëse e Romëve "Meseçina" – Gostivar, me degët në Dibër dhe Kërçovë,
 Organizata Humanitare "El Hilal" – Shkup, me degët në Kumanovë, Tetovë dhe Gostivar,
 Organizata Humanitare (Rome) "Mir" – Shkup,
 Organizata Humanitare (Rome) "Homos" – Shkup,
 Qendra për Bashkësi Rome "Drom" – Kumanovë,
 Lidhja e Maqedonasve me Religjion Islam – Shkup,
 Shoqata Humanitare Bamirëse "Nëna Terezë" – Strugë,
 Lidhja e Gruas Shqiptare në Maqedoni – Tetovë, me degën në Gostivar,
 Organizata e Grave – Probishtip,
 Shoqata e Prindërve me Vetëndihmë "Nadezh" – K oçanë,
 Shoqata e Nënave me Vetëndihmë – Shtip,
 Shoqata e Grave Serbe në RM – Shkup,
 Organizata Humanitare (e dioqezës së Manastirit të KOM) "Voskresenie" – Manastir,
 Kisha Ungjillore – Metodiste – Strumicë,
 Shoqata Humanitare e Romëve në RM "Sonce" – Tetovë



➤ Zyra në Gjakovë, prej ku u udhëhoqën të gjitha aktivitetet

PREZENCA E PARË E QMBN-SË NË KOSOVË

Nga fundi i muajit qershor të vitit 1999, QMBN vendosi në mënyrë aktive të punojë, e jo vetëm të flasë për bashkëpunimin e mirë fqinjësor dhe rajonal, duke e bërë hapin e parë jashtë Maqedonisë, me programin Përtëritja e jetës në Kosovë. Qëllimi ishte të nxiten zgjidhje paqësore dhe të drejta për dallimet ekzistuese dhe avancimin e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimin dhe jetën e përbashkët paqësore mes të gjithë atyre që jetojnë në Kosovë dhe në rajon. Me këtë program, u mbështetën bashkësitë në përtëritjen e jetës pas konfliktit, nëpërmjet meremetimit të vendbanimeve dhe infrastrukturës tjetër, sigurimin e ushqimit, ndihmë bujqësisë, krijimin e bazës për gjenerimin e të ardhurave dhe mbështetje organizatave lokale qytetare. Për këtë qëllim, QMBN hapi zyra lokale në Gjakovë dhe Dragash, ku punonin 20 persona.

Programi Përtëritja e jetës në Kosovë zbatohet në pjesën jugperëndimore të Kosovës, gjegjësisht në 43 fshatra nga komuna e Gjakovës, Rahovecit, Prizrenit dhe Dragashit. Aktivitete të caktuara, siç është zhvillimi i shoqërisë civile dhe mbështetja e mediave, zhvillohet në gjithë territorin e Kosovës. Me mbështetje u përfshinë rreth 48.700 shfrytëzues.



➤ Zhak Vilemse dhe Karel Rihters, anëtarë të Konzorciumit për Maqedoninë dhe Sasho Klekovski nga QMBN për vizitë pune në Kosovë

11



➤ Anëtarët e KD të QMBN për vizitë në një familje në Gjakovë



➤ Njerëzit mundohen të mbijetojnë në momentet e vështira pas luftës

Rikonstruimi i shtëpive

Aktiviteti më i madh i QMBN-së në Kosovë ishte sigurimi i vendbanimeve për refugjatët, të cilët ktheheshin në shtëpitë e tyre. Ndihma përbëhej nga: strehime të përkohshme, rikonstruimi i shtëpive dhe sigurimi i vendbanimeve montuese.

Refugjatët të cilët ktheheshin në shtëpi nuk kishin kushte elementare për jetë, as kulm mbi kokë, e pasi që afrohej dimri, duhej të siguroheshin vendbanime të përkohshme ose të bëhej rikonstruimi i shtëpive me dëmtime më të vogla.

QMBN për 171 familje siguroi ndihmë në tenda, krevate, dyshekë, çarshafë dhe batanije. Kjo ndihmë u sigurua nga Aksioni i Kishave Bashkë (ACT).

Aktiviteti më intensiv ishte ai i rikonstruimit të shtëpive, i cili përfshinte kulm të fortë, dy dhoma, kuzhinë, banjë, furnizim me ujë dhe energji elektrike. QMBN gjatë vitit 1999 dhe 2000 mbështeti 160 familje, të cilët jetonin në 151 shtëpi, në 11 fshatra dhe qytetin e Gjakovës, si dhe të gjitha 27 familjet me shtëpi të dëmtuara në komunën e Dragashit. Seleksionimi u bë në bashkëpunim me këshillat e fshatrave, ndërsa për rastet në komunën e Dragashit dhe Gjakovës në konsultim me autoritetet komunale. Për kujdesin e familjeve të cilat shtëpi janë klasifikuar në kategorinë e 5 (shtëpi që nuk mund të rikonstruohen), QMBN në bashkëpunim me partnerët tjerë të ACT-it në Kosovë siguroi 136 shtëpi montimi, që u distribuan dhe montuan para ardhjes së dimrit.

12



➤ Gjakova në ditët e para pas luftës



➤ Distribrimi i materialit ndërtimor për përtëritjen e vendbanimeve



➤ Fëmijët i gëzohen shtëpisë së re

Ndërtimi i fshatit të shkatërruar

Shefqet Brahimaj është agronom, drejtor i kombinatit bujqësor në fshatin e tij. Nëse dikush nuk ju tregon se ai ka 50 vjet, do t'i mahniteni elasticitetit të tij të "paktën 70 vjeçarit" Shefqet. Kombinimi i fytyrës me plotë rrudha dhe trupit të fuqishëm dhe i lëvizshëm do t'u b[het logjike pasi të kuptoni se fshati i tij pothuaj shtatë vjet ka qenë rajon konflikti.

Shqiponja, siç e quajnë tani, ose Jabllanica, siç e quanin deri në ardhjen e paqes, është fshat në Gjakovë me 131 shtëpi, me rreth një mijë banorë. Në mars të vitit 1997 ka qenë e granatuar dendur. Fshatarët kanë mbetur aty deri në fund të luftës, edhe pse gjatë sulmeve, shtëpitë e tyre, deri te e fundit, janë dëmtuar.

Ata nuk e braktisën fshatin as pas përfundimit të luftërave në vitin 1999 dhe, krahas mungesës së kushteve themelore për jetë. Numri më i madh i traktorëve janë shkatërruar tërësisht, ndërsa ata që kanë "mbijetuar" janë dëmtuar. Deri në fund të vitit janë riparuar 22 traktorë.

Punët ndërtimore ishin edhe shkaku pse atë mëngjes dhjetori shkuam në fshat. Pasi që rikonstruimi i shtëpive ende nuk kishte filluar, pjesën më të madhe të fshatarëve dimri i zuri nën tenda. Me ne ishte inxhinieri nga Shqipëria, i cili duhej të organizojë demonstrimin e ngritjes së shtëpisë montuese para fshatarëve, të cilët më vonë vetë do t'i montonin.

Shkuam në shtëpinë e Shefqetit. Në oborr rrinte "plaku" me disa bashkëfshatarë. Inxhinieri Pirro menjëherë u tret prapa mureve të njërës nga shtëpitë e rrënuara në oborr. Prej atje dëgjoheshin goditje të çekanit. Disa djelmosha veç më kishin nisur me montimin e shtëpisë montuese për familjen e vëllait të Shefqetit. Materialet për shtëpitë montuese kishin arritur, ndërsa djelmoshat kishin filluar me montimin e dërrasave, ose nga padurimi ose për shkak të arritjes së të ftohtit.

Derisa rrinim në oborr, vazhdimisht rreth nesh rrotulloheshin zogat. Edhe ato Shefqeti i mori nga QMBN-ja. Vetë përmendja e idesë për distribuimin e zogave te shumica nxiti të qeshurit, por reagimi i fshatarëve megjithatë tregoi se është shumë praktike. Ata, përditë marrin vezë.

Shqiponjën ose Jabllanicën e lamë prapa vetes, nëpër një rrugë tjetër, tani nëpër male, plotë me fishekë të ndryshëm, të mbetura nga koha e shembjes.



➤ Ndhëma në ushqim ishte e mirëseardhur për të gjithë

Ndihmë me ushqim

QMBN filloi edhe me distribuimin e ushqimit, gjatë së cilit u përfshinë 43 fshatra. Në periudhën gush-tetor 1999, u bënë distribuime mujore të pakove me ushqim dhe me prodhime higjienike, nga rezervat e ACT-it që u sollën nga Shqipëria. Në nëntor dhe dhjetor për fshatrat në rajonin e Gjakovës dhe vetë qytetin, u organizua distribuim nga Maqedonia, derisa për të gjitha 36 fshatrat nga rajoni i Dragashit u përgatitën pako “dimërore” dhe u krye distribuimi i njëhershëm i ndihmës.

Fshati Senoc e përjetoi më të vështirën

“QMBN është organizata e parë e cila e ndihmoi fshatin. Në fillim ishte ndihmë me ushqim, veshmbathje dhe prodhime higjienike, e më vonë filloi edhe distribuimi i materialit ndërtimor dhe pakove me vegla. Ndihma ishte e domosdoshme për fillim të një jetë normale, pasi që dëmtimet në fshat, ishin të mëdha, rreth 90%”, na tha Faredin Krasniqi, kryetari i fshatit.

Fshati ka rreth 900 banorë. Pasi që punët me rikonstruim filluan vonë, arriti dimri, me çka u vështirësua distribuimi i materialit ndërtimor. Në fshat u ndërtua shtëpia e kulturës dhe një kopësht për fëmijët. Disa nga fshatrat e kategorisë 4, ende nuk janë rikonstruar. Shumica e fshatarëve merren me bujqësi, derisa të tjerët gjenden në kurbet.

“Kur në pranverë filluan veprimet luftarake, popullata iku nga fshati, mbetën shumë pak. Në qershor u kthyen të gjithë. Shtëpia ime ishte shkatërruar tërësisht dhe pothuaj katër muaj flinim jashtë nën tendë. Kur binte shi, uji na hynte brenda. Por njeriu duron çdo gjë”, na tha Faredini në fund të bisedës.



➤ Distribuimi i ushqimit në fshatin Rastelicë, Dragash



➤ Pako me ushqim për banorët e fshatit Senoc

PËRKRAHJE BUJQËSISË

Aktivitetet në fushën e bujqësisë përfshinë më shumë aspekte. Mbështetja në bujqësi ishte siguruar nëpërmjet distribuimit të pulave-kloçka, ushqimit për kafshë, pajisjeve të ndryshme bujqësore dhe me riparimin e traktorëve.

Ndihma në riparimin e traktorëve dhe pajisjeve bujqësore u kryen në bashkëpunim me partnerin e QMBN-së, Diakonisches Ėerk nga Gjermania. Identifikimi u bë në fshatrat nga rajoni i Gjakovës dhe Dragashit. Në të dy fshatrat u hapën servise për riparim. QMBN nënshkroi marrëveshje me pronarin e servisit, me të cilin obligohet që t'i kompensojë mjetet e investuara në servisin e tij me punën e nevojshme për riparim në interes të bashkësisë. Në fund të muajit korrik të vitit 2000, u krye identifikimi i 200 shfrytëzuesve të mekanizmit bujqësor nga 23 fshatra të Kosovës Jugperëndimore dhe miratoi ndihmë për riparim të rreth 150 traktorëve, 50 multikultivatorëve dhe 6 kombajnave.

Gjatë muajit maj të vitit 2000, u distribua ndihmë për 2000 familje të cilat jetonin në 16 fshatra nga komuna e Shtërpçës, prej të cilëve 11 të banuara me serbë etnikë, ndërsa 5 me shqiptarë etnikë. Ata morën ndihmë në ushqim për kafshë, pleh artificial dhe pula kloçke. Kjo kontribuoi që të plotësohen nevojat e popullatës, e cila jeton e izoluar me resurse të pamjaftueshme të veta. Numri më i madh prej tyre është marrë me bujqësi. Por, pothuaj izolimi dyvjeçarë, veçanërisht i vendbanimeve ku jetonin serbët etnikë, nga pjesa tjetër e Kosovës u krijonte vështirësi banorëve. Pamundësia që të tregtohet me mallrat, i kanë detyruar të gjithë blegtorët ta therin pjesën më të madhe të kafshëve të cilat i kishin për të shitur.

Përveç kësaj, Nga Shtërpca janë tërhequr të gjitha organizatat ndërkombëtare, të cilat kryesisht kanë siguruar ndihmë në ushqim. Për ta distribuar ndihmën, QMBN-ja zhvilloi bashkëpunim me autoritetet lokale dhe organizatat qytetare në Shtërpçë. Ato kanë qenë përgjegjës për identifikimin e shfrytëzuesve të ndihmës dhe për distribuimin final.



➤ Në pjesën jugperëndimore të Kosovës u bë ndreqja e rreth 150 traktorëve të dëmtuar, 50 multikultivatorëve dhe 6 kombajnave



➤ Distribuimi i ndihmës për fshatrat e banuara me serbët etnik

Më vullnet dhe dëshirë, deri te rezultatet e mëdha

Gjatë vizitës së parë në Gjakovë, QMBN identifikoi një fabrikë për prodhimin e qumështit, në fshatin Sheremet. Gjendja pas luftës ishte shumë e vështirë, rreth 80% nga objekti dhe makinat ishin shkatërruar. QMBN pronarit të fabrikës, Sali Golaj, i miratoi ndihmë në vlerë prej 75.000 euro për fillimin e prodhimit, që pastaj do të kthehej me dërgimin e prodhimeve të qumështit në shkollat dhe institucionet sociale.

“Në familje nuk kishim shpresë se do të vazhdojmë me punë. Shpresa e vetme ishte që dikush të na ndihmojë. Dhe në atë moment u paraqit QMBN-ja, e cila na dha shpresë për të filluar me punë. Mjetet ishin të mjaftueshme që të kthehemi në gjendjen e mëparshme. Në prill të vitit 2000 e aktivizuar fabrikën. Ishte një kënaqësi e madhe për ne, por edhe për gjithë rajonin”, na tha Saliu.

Në fillim në fabrikë punonin pesë persona, derisa sot janë 14. Numri i fermerëve prej të cilëve blihej qumështi, nga dita në ditë, rritet. Sot ka arritur në 100. Kërkesa e tregut po shtohet, por jo në nivel të mjaftueshëm për shkak të politikës aktuale ekonomike. Në fabrikë prodhohen të gjitha prodhimet e qumështit, me përpunimin e rreth 1400 litrave qumësht.

“Shpresojmë se me kohë do ta përmirësojmë teknologjinë në fabrikë, prandaj edhe çdo vit investojmë në makina të reja. Me këtë do ta rrisim prodhimtarinë, që është mundësi për punësime të reja në rajonin tonë”, na tha në fund të bisedës Saliu.

Ndihmë edhe për serbët etnikë

Pas katër viteve nga vizita e parë e QMBN-së në Brezovicë dhe Shtërpçë, erdhëm t'i vizitojmë këta njerëz, jeta e të cilëve nuk ka ndryshuar që atëherë. Njerëzit na shihnin me çudi, pak të habitur. Kur ju thamë se jemi nga QMBN-ja, iu kujtua ndihma të cilën e distribuam në atë kohë. E kërkuam Dragolubin, i cili atëherë ishte përgjegjës për distribuimin e ndihmës deri te shfrytëzuesit. Shtëpia e tij gjendej pranë rrugës për në Prizren. Dragolubi doli nga shtëpia dhe si i habitur na shihte. U përshëndetëm dhe qe, Dragolubi na njohu.

- “Ç’ju solli këtej, ne menduam se na keni harruar”, tha Dragolubi me buzëqeshje. “Popullata është shumë mirënjohëse për ndihmën e pranuar. Pyesin, ku janë njerëzit që na ndihmuan atëherë. Nuk na harruan njerëzit nga Maqedonia, në ato momente të vështira. Organizata të tjera nuk ndihmuan në fshatin tonë. Gjatë konfliktit ishte shumë keq, ndërsa pas luftës nuk mund të dilnim nga fshati. Ishim të izoluar nga bota. Nuk kishim as benzinë për multikultivatorët”, fliste Dragolubi derisa e pinim kafën në oborr.

Ai rrëfente se si njerëzit më shumë punojnë në organizatat ndërkombëtare, ndërsa disa prej tyre merren me bujqësi. Shumë pak u mbetet për shitje të prodhimeve. Ai tha se ende ka persona të zhvendosur. Në Brezovicë ka rreth shtatëqind banorë dhe treqind persona të zhvendosur.

U ndamë nga Dragolubi dhe nga Brezovica. Rrugës vazhdimisht qarkullonin vetura të policisë kosovare. Shpresojmë se këta njerëz do ta gjejnë qetësinë e tyre.



➤ Qumështorja “Golaj” sot është shembull për punë të suksesshme



➤ Dragolubi nuk i ka harruar miqtë nga Maqedonia

MBËSHTETJE MEDIUMEVE

QMBN e mbështeti këshillin redaktues të javores prishtinase “Zëri”, i cili ballafaqohej me probleme të mospasjes së pajisjes adekuate teknike për punën e rregullt. Me këtë projekt u mundësua botimi i mëtejshëm i javores, si dhe publikimi i gazetës ditore “Zëri”, për informimin më të mirë të opinionit për ngjarjet aktuale.

Në fillim të qershorit të vitit 2000, QMBN bashkë me organizatën qytetare nga Gjakova “Ne Jemi Me Ju” filloi ta zbatojë projektin “Trajnim për gazetarët”. Kjo parashihte mbështetje medimeve në Kosovë nëpërmjet organizimit të trajnimit për gazetarë, me çka do të kontribuohet drejt zhvillimit dhe forcimit të shoqërisë civile dhe demokratizimit. Trajnimi u zhvillua në dy faza: trajnimi i trajnuesve dhe shkolla për gazetarë të rinj.

Në fazën e parë u mbajt kursit 12 ditorë për 15 gazetarë me përvojë nga rajoni, në Neum, dhe në Sarajevë, nga 17 deri më 28 qershor. Pjesa e dytë e përfshiu formimin e qendrës për trajnim të gazetarëve të rinj nga Gjakova.

GJENERIMI I TË ARDHURAVE

Në këtë pjesë u mbështet fabrika për prodhimin e tullave IMN nga Gjakova, e cila punësonte 220 persona. Prodhimtaria në këtë fabrikë u përtëri gjatë nëntorit të vitit 1999, ndërsa ndihmën që e siguroi QMBN u pagua me prodhime, që u përdorën për ndërtimin e shtëpive.

Në periudhën 1999-2000, përveç ndihmës urgjente, u zbatuan edhe aktivitete për furnizimin me ujë të fshatrave, distribuimin e repromaterialeve bujqësore për mbjelljet pranverore dhe në vjeshtë, si dhe u siguruan lopë për 165 familje dhe për Shoqatën e Prodhuesve të Qumështit në Gjakovë.

Të gjitha këto aktivitete kontribuan për të ndihmuar fshatrat pas konfliktit dhe përtëritjen e kapaciteteve të tyre prodhuese, kryesisht në fushën e bujqësisë, pasi që bëhet fjalë për rajone rurale. QMBN, si dhe në programet e tjera, udhëhiqej nga nevojat e njerëzve dhe përpiquej të disejnojë ndihmë në pajtim me këto nevoja. Një nga metodologjitë më të suksesshme të vlerësuara ishte përdorimi i vauçerëve për repromaterialet bujqësore, me të cilat familjet fermere mund të zgjedhin prodhime, të cilat u nevojiten më së shumti nga barnatoret lokale bujqësore.



➤ Fabrika për prodhimin e tullave IMN në Gjakovë

QMBN VAZHDOJ ME PROGRAMET

2001-2002

Me përfundimin e fazës së emergjencës dhe me përvojën e vet, QMBN filloi program zhvillimor, tërësisht i realizuar nëpërmjet shoqatave qytetare lokale (SHQ). Gjatë viteve 2001-2002 u zbatua programi Tranzicioni në Kosovë (TKS).

QMBN i identifikoi tre partnerë të tillë në Kosovë, të cilët vazhduan dhe e ndiqnin angazhimin dhe arritjet e QMBN-së në Kosovë: Ne Jemi Me Ju (NJMJ), Qendra Kosovare për Zhvillim (QKZH) dhe Iniciativa e Femrave Kosovare (IFK). Secila prej tyre u fokusua dhe ishte përgjegjëse për pjesë të ndryshme të programit. Në këtë kontekst, QMBN e vazhdoi prezencën e vet në Kosovë si lidhje, që të sigurojë: transformim të vazhdueshëm të programeve nga ato të emergjencës drejt atyre zhvillimore; zbatimin nga SHQ lokale, në vend nga QMBN-ja; ndihmë adekuate dhe udhëheqje të SHQ lokale, si dhe ndërtimi i kapacitetit të tyre; sigurimi i vazhdimit adekuat të aktiviteteve të mëparshme të cilat SHQ lokale nuk do të mund t'i mbulojnë në tërësi (psh. rajoni i Dragashit).

Në kuadër të programit TKS u miratuan dhe u zbatuan aktivitete nga 47 projekte.

Një nga vlerat kryesore nga inkuadrimi i QMBN-së në këtë program është aftësimi i SHQ partnere lokale në Kosovë.

Në këto suaza, në maj të vitit 2002 u zbatua trajnimi për udhëheqje me cikël projekti, me qëllim që të sigurohen dituritë themelore për fazat e projektit, që të vendoset sistemi adekuat për menaxhim me projekte në këto organizata. Grupi qëllimor i trajnimit ishin të punësuarit në SHQ lokale, të cilat ishin zbatues të drejtpërdrejtë të aktiviteteve të programit TKS. Në trajnim morën pjesë të punësuar dhe aktivistë të organizatave, ndërsa u zbatuan në Mitrovicë nga dy trajnues nga QMBN.

Aktiviteti i dytë në këtë pjesë ishte projekti Trajnimi për Zhvillim Institucional dhe Fuqizim Organizativ (ZHI/FO) për partnerët lokalë. Me këtë projekt u zbatua trajnimi për udhëheqjet e partnerëve lokalë në Kosovë, të cilët u njoftuan me metodologjinë për udhëheqje më efikase me organizatat. Trajnimi u zbatua në muajin korrik, ndërsa morën pjesë 11 persona.



➤ Bujqit i shkëmbejnë përvojat



➤ Trajnim për shoqatat lokale



NË JEMI ME JU

Organizata joqeveritare “Ne Jemi Me Ju” u themelua në korrik të vitit 1999, menjëherë pas luftës në Kosovë. Në organizatë ishin inkuadruar profesionistë nga fusha të ndryshme.

Misioni

SHQ “Ne Jemi Me Ju” me aktivitetet e veta e mbështeti konceptin e zhvillimit të mentalitetit dhe kulturës demokratike, ku qytetari me idetë kreative dhe aftësitë është në gjendje të kontribuojë për mirëqenien sociale dhe ekonomike të individit dhe bashkësisë.

Lufta për shoqëri tolerante, demokratike dhe paqësore është dhe do të jetë synimi i përhershëm i organizatës.

Qëllimet e organizatës janë: inicimi dhe mbështetja e iniciative lokale; zhvillimi i shoqërisë civile dhe kulturës demokratike; krijimi i parakushteve për dialog multietnik; shëndetësia; edukimi arsimor dhe kulturor; mirëmbajtja e ambientit dhe promovimi i nevojave për ushqim të shëndoshë dhe cilësor.

Organizata realizoi aktivitete si organizimi i seminareve, ligjëratave, promovimi dhe zhvillimi i trajnimeve për projekte të shoqërisë civile; publikimi i lifletëve, posterëve, broshura me karakter edukativ; organizimi i kampeve verore edukative për të rinj; sensibilizimi dhe ndërtimi i vetëdijes së opinionit për mbrojtjen e ambientit; organizimi i koncerteve, ekspozitave dhe mbrëmjeve kulturore; inicimi dhe mbështetja e projekteve me karakter zhvillimor.

Grupi qëllimor

Të rinjtë, gratë, personat me nevoja të posaçme, nacionalitetet dhe individët profesionistë.

Organizata për periudhën e ekzistimit të saj realizoi projekte të shumta. Nga ato do të veçojmë disa, si: “Riintegrimi i ish luftëtarëve të UÇK-së në jetën civile”, ku 168 ish-luftëtarëve iu mundësua adoptimi dhe riintegrimi në jetën civile. U realizuan kurse për kompjuterë, për gjuhë angleze, për ndihmë psiko-sociale, për shkathtësi zejtarie etj. “Edukimi seksual i adoleshentëve” është projekt i cili zgjati gjashtë muaj dhe u zbatua në disa qytete dhe fshatra. Në këtë projekt dy mjekë të angazhuar arritën që ta zbatojnë edukimin seksual të adoleshentëve, duke i kontribuar luftës kundër aborteve artificiale dhe joligjore dhe planifikimin e jetës seksuale të të rinjtë; “Etika gazetareske dhe liria e shtypit” ishte seminar dyditor ku morën pjesë 20 gazetarë dhe ku ligjërues ishin gazetarë të dalluar kosovarë. Të pranishmit në seminar u pajtuan se liria e shtypit në Kosovë është rrezikuar.



➤ Dituri të reja për realizimin më të mirë të projekteve në praktikë

Ne Jemi Me Ju (WAWY) ishte përgjegjëse për zhvillimin institucional dhe forcimin organizativ të SHQ. U realizuan pesë trajnime për SHQ lokale nga rajoni i Rahovecit, Malishevës, Deçanit, Klinës dhe Skenderajt; u publikuan pesë numra të buletinit për shoqëri civile, u zbatuan edhe tre projekte për lobim dhe përfaqësim: Koalicioni dhe rrjeti i SHQ (krijimi i rrjetit të bashkëpunimit mes SHQ nga rajoni i Kosovës Jugperëndimore); Korniza ligjore për SHQ (njohja e SHQ me parimet themelore të kornizës ligjore për SHQ në Kosovë); Tribuna publike për politikën tatimore për SHQ (informimi i SHQ për politikën e re tatimore në Kosovë, si dhe njoftimi i SHQ për obligimet e veta dhe përgjegjësitë ndaj Pushtetit qendror fiskal të Kosovës); Financimi mikroprojektor i SHQ lokale (u dhanë dhjetë grante për SHQ nga Kosova Jugperëndimore).

Me trajnime deri te më shumë dituri

Nga 18 deri më 22 qershor të vitit 2002, në Deçan u mbajt trajnimi për udhëheqje me cikël projekti, në të cilin morën pjesë 15 pjesëtarë të shoqatave qytetare nga Deçani.

Në trajnim u trajtuan temat standarde si: planifikimi dhe rëndësia e planifikimit; krijimi i drurit të qëllimeve, grupimi i problemeve, seleksionimi i strategjisë/logjikës së intervenimit, analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve, qëndrueshmëria financiare, aloçimi i resurseve, metodat e vendosjes së sistemit të vëzhgimit të ciklit të projektit etj.

“Kaluam ditë të mira pune, mendoj se me pjesëmarrjen në trajnime të këtilla, dituria zgjerohet më shumë”, na tha Astrit Basriu nga Shoqata e qytetarëve “Epoka e Re” nga Deçani. “Prezantimi ishte shumë i suksesshëm dhe i afërt për ne. Na mbetet atë që e dëgjuam ta zbatojmë në organizatat tona. Flas personalisht për mua, pasi që nuk kam përvojë në përpilimin e projekteve”, na tha ai.

“Organizata ku jam anëtar, mendoj se duhet të më dërgojë në trajnim të këtillë që të inkuadrohem sa më shumë në projekte. Pritjet ishin të njëjta, atë që e pret para çdo trajnimi. Të mësoh diçka të re, të supozosh se atë që e di do ta kanalizosh në ndonjë mënyrë, se do të marrësh përgjigje në të gjitha pyetjet dhe paqartësitë”, na tha në fund të trajnimit Lumnie Jusufi nga “Këshillat familjare”, nga Deçani.

Trajnimit u zbatuan Bekim Sejdiu (FKSHC), Arbnor Pula (FID), Arta Zherka (Instituti Lindje-Perëndim) dhe Luan Gola (Ne Jemi Me Ju).



➤ Trajnimi i aktivistëve të shoqatave të qytetarëve



➤ Pjesëmarrësit e trajnimeve presin përgjigje për shumë pyetje

QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM

Qendra Kosovare për Zhvillim (QKZH) paraqet organizatë qytetare dhe joprotabile, e cila u themelua në vitin 2001 nga ana e iniciativave lokale dhe u përkrah nga QMBN dhe ICCO. Qendra Kosovare për Zhvillim është regjistruar në UNMIK, me numrin e regjistrimit 510105-8. Struktura e menaxhmentit është përbërë nga: kuvendi, këshilli, drejtori ekzekutiv, bashkëpunëtorët e projekteve, administratori, kontabilisti. Po ashtu, në varshmëri nga nevojat, për projekte të caktuara inkuadrohen edhe bashkëpunëtorë të rinj.

Qëllimi i organizatës:

Qëllimet strategjike të QKZH janë:

- përmirësimi i pozitës sociale dhe ekonomike të bujqve në Kosovë;
- zhvillimi i shoqërisë civile;
- distribuimi i ndihmës grupeve që kanë nevojë.

QKZH vepron në këto sektorë:

- zhvillimi i mjediseve rurale;
- punësimi dhe gjenerimi i të ardhurave;
- shoqëria civile dhe demokracia;
- informimi dhe publikimi.

Fusha të intervenimit (numri i sektorëve të përfshirë, pushteti lokal, fshatrat): QKZH kryesisht është aktive në pjesën jugperëndimore të Kosovës, por edhe në rajonet tjera në Kosovë. QKZH i përfshinë fshatrat nga 15 njësi të vetëqeverisjes lokale: Prizreni, Rahoveci, Gjakova, Istoku, Deçani, Peja, Vitia, Skënderaj, Drenasi dhe Vushtria.

Llojet e intervenimit (përshkrim i shkurtër i aktiviteteve këshillëdhënëse dhe të tjera):

Produktet kryesore dhe shërbimet që i ofron QKZH përfshijnë:

- rritjen e kërkesës për shërbime;
- grante me vlerë të vogël për
 - a) iniciativa për zhvillim të bashkësive dhe
 - b) forcimin e bashkëpunimit;
- zhvillimi i kapaciteteve të shoqatave lokale nëpërmjet trajnimeve dhe kurseve;
- mbështetja organizative për shoqata të bujqve;
- shkëmbimi i informatave për zhvillim rural;
- informimi (nëpërmjet broshurave dhe informatorëve);
- shkëmbimi i informatave për sektorin e bujqësisë;
- përfaqësimi dhe lobimi për mbrojtje të drejtës së konsumatorëve, kontrolli i cilësisë së ushqimit dhe mbështetja e sektorit të bujqësisë;



➤ Në një nga mbledhjet e personelit

- mbështetje financiare për zhvillim të iniciativave nëpërmjet granteve.

the food quality and support of agricultural sector;

- *Financial support for initiative development through grants.*

Familjet e bujqve shfrytëzues të aktiviteteve të QKZH: 15 bashkësi lokale, 30 fshatra dhe afër 5000 shfrytëzues. Popullata e përcaktuar (klientët, partnerët): Shoqata të bujqve, sipërmarrës dhe bujq individualë, të veja, grupe të minoriteteve.

Qendra Kosovare për Zhvillim (QKZH) ishte përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve për zhvillim socio-kulturor të bujqve në mjediset rurale. U zbatuan gjithsej gjashtë trajnime dhe u botuan katër numra të Agrobuletinit, dedikuar bujqve individualë, shoqatat e bujqve dhe kooperativat bujqësore. U realizua edhe projekti Mbështetje për formimin e shoqatave të bujqve. QKZH i udhëhoqi punëtoritë për procesin e formimit të gjashtë shoqatave. U dha edhe ndihmë teknike për fermerët, të cilët u aftësuan për udhëheqje të suksesshme me ferma dhe rritja e prodhimit.

Shembullin e Hasanit duhet ta ndjekin edhe fermerët e tjerë

Hasan Halili nga fshati Bec, Gjakovë, merret me kultivimin e perimeve: domates, specit, kastravecëve, si dhe patates dhe shalqit. Ai posedon sipërfaqe prej 12 hektarëve tokë të punueshme.

Me këtë ai merret prej 30 vjetësh. Ai na tha se në të kaluarën ka pasur fitim më të madh nga perimet. Këtë vit ai ka mbjellur domate në oranzheri, derisa nën qiell të hapur – patate, spec, lakër, shalqi, qepë e tjera.

“Me kultivimin e perimeve nën qiell të hapur kemi përvojë më të madhe, derisa me oranzheri filluam të merremi nga viti 2000. Duke iu falënderuar QKZH-së, përveç ndihmës së ofruar me materiale, fituam përvojë të madhe edhe në kultivimin e perimeve në oranzheri, që është shumë e pranueshme për ekonominë familjare”.

Ai është i kënaqur nga çmimet që i ofron tregu kosovar, pasi që për kohën kur plasohen prodhimet ndodh invazion i mallrave nga vendet fqinje, që shkaktojnë nervozë të madhe dhe dëm.

“Këtë vit”, theksoi Hasani, “kemi probleme të mëdha edhe me kushtet atmosferike, pasi që perimet që janë mbjellur nën qiell të hapur i ka kapluar sëmundje të ndryshme dhe trajtimin të cilin e aplikuam ishte i pasuksesshëm, pasi që vazhdimisht bie shi dhe kohë pas kohe ka diell të fortë, i cili shkakton pasojë të shumta për shfaqjen e sëmundjeve.

Duhet të themi se shembulli i këtij bujku nga Beci është shembull për inspirim. Hasani me anëtarët e tjerë të familjes punon në fushë, duke siguruar mjete për jetë për familjen 13 anëtarësh.



➤ Hasani para fidanëve të tij



➤ Trajnim për shoqatat e bujqve



➤ Fëmijët i gëzohen peshqesheve të Vitit të ri

INICIATIVA E FEMRËS KOSOVARE

Vizioni

Ne dëshirojmë të jetojmë në një shoqëri ku femra do të ketë barazi gjinore, ku ajo do të emancipohet dhe do të profesionalizohet në çdo lëmi të jetës.

Misioni

Iniciativa e Femrës Kosovare është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse që i shërben zhvillimit ekonomik, arsimor dhe demokratik të shoqërisë civile e në veçanti femrës nëpërmjet projekteve dhe programeve, të cilat fuqizojnë qëndrueshmërinë e sektorit pa përfitim dhe përmirësojnë strukturat profesionale.

Iniciativa e Femrës Kosovare në Gjakovë është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e formuar menjëherë në qershor të vitit 2001.

Që në fillimet e saj, organizata ka synuar të ndihmoj përfshirjen e gruas dhe të të rinjve në jetën shoqërore nëpërmjet ofrimit të programeve të forcimit të pozitës së tyre, të arsimit dhe të edukimit si dhe të programeve për zhvillimin ekonomik, duke iu ofruar trajnime të shumta për të menaxhuar me bizneset e tyre.

Programi i përfshirjes së gruas në jetën shoqërore ka synuar ndihmën, këshillimin, trajnimet lidhur me përfshirjen e barazisë gjinore në të gjitha aspektet, e sidomos në fushën e politikës, pastaj për ndërmjetësimin e zgjidhjes së konflikteve të ndryshme në familje, formimin e grupeve rinore monitoruese të ansambleve komunale. IFK ka qenë pjesëmarrëse e hartimit të Planit Strategjik Nacional për Barazinë Gjinore, i cili tani funksionon si Ligj pas aprovimit nga Parlamenti i Kosovës.

Programet e edukimit dhe të arsimit kanë synuar ndërgjegjësimin e grave dhe minoriteteve lidhur me pozitën dhe rolin e tyre në shoqërinë kosovare, dhe rritjen e përfshirjes së tyre në jetën shoqërore. Në kuadrin e këtyre programeve përfshihen aktivitete të ndryshme, si: trajnimi i grave dhe vajzave për avokim, të rinjve të kombësisë boshnjake për kursin e gjuhës shqipe, trajnimet e qytetarëve të Gjakovës për pjesëmarrje qytetare dhe avokim etj. Janë organizuar tryeza të rrumbullakëta, debate dhe seminare për të drejtat e grave, të rinjve dhe qytetarëve për rolin e tyre në shoqëri. IFK është njëra nga organizatat më aktive qytetare në Gjakovë dhe ka bashkëpunim të mirë me organizata të ndryshme qytetare dhe qeveritare në Gjakovë dhe komunat tjera.

Iniciativa e Femrës Kosovare (IFK) ishte përgjegjëse për zhvillimin e shoqërisë qytetare me fokus të çështjes së gruas. U zbatuan projekte nga pjesa për trajnime të grave dhe dhunës në familje, njohja me të drejtën trashëguuese dhe trajnimi për avancimin e biznesit. Në pjesën për forcimin e vetëdijes, u zbatua projekti për integrim të gruas në

jetën shoqërore. U zbatuan edhe projekte nga kultura, si dhe promovimi i punimeve të dorës, ekspozita e punimeve tradicionale të dorës dhe ekspozita e punimeve të thurura me dorë.

Ta ruajmë traditën

Në Kosovë tradita e artizanatit kultivohet ndër shekuj. Punimet tradicionale me dorë, ende janë atraktive për shumicën e njerëzve, si për kosovarët, ashtu edhe për të huajt, të cilët në Kosovë janë me numër të madh. Por, kësaj here, ato nuk ishin dedikuar për gjenerimin e të ardhurave, por kishin karakter humanitar.

“Ideja lindi rastësisht. Në bisedën me një miken time, më tha se nëna e saj thurë, por nuk ishte e kënaqur nga shitja. Pasi që afrohej Viti i Ri, mendoja si t’i gëzojmë fëmijët pa prindër, e thash: ndoshta bashkërisht diçka mund të organizojmë”, na tha Ardita Rizvanolli, udhëheqëse e projektit.

Në këtë aktivitet ishin kyçur gratë të cilat merreshin me artizanat. Gratë kishin prejardhje nga komuna të ndryshme, e veçanërisht ishte e rëndësishme të përmendet fakti se në projekt ishin kyçur edhe gratë nga bashkësitë e pakicave. Grupet e grave, të cilat merreshin me artizanat ishin nga: Hoça e Madhe (rajon i banuar me boshnjakë), Rahoveci, Prizreni, Gjakova dhe Peja. Ekspozita mbeti e hapur 3 javë gjatë muajit nëntor, në galerinë e ekspozitave “Vizioni i ri 2000+” në Gjakovë.

Prodhimet, të cilat u ekspozuan, ishin të dedikuara për shitje, derisa me mjetet e grumbulluara u blenë dhurata për fëmijët pa prindër dhe nënat kujdestare të familjes.

Gjatë festave të Vitit të Ri u ndanë dhurata për fëmijët pa prindër dhe për nënat kujdestare.

Iniciativa në Dragash

Në kuadër të programit Tranzicioni në Kosovë (TKS), u mbështetën edhe iniciativa të vogla zhvillimore në Dragash, ku u realizuan tetë projekte:

Kurse të gjuhës angleze (në organizim të SHQ Flaka) dhe Kurse për kompjuterë (Nëna Terezë), e kishin për qëllim aftësimin e aktiviteteve të SHQ me dituri themelore për gjuhën angleze dhe punën me kompjuterë. Ngjashëm, me projektin Mbështetja teknike e SHQ Vatan, u ndihmua organizata e sapoformuar e pakicës së goranëve në Dragash.

Furnizimi me ujë i fshatrave Brut dhe Kosavë, meremtimi i urës në f. Baçkë, vendi për lojëra për fëmijët dhe meremetimi i nyjes sanitare i ambulancës në fshatin Krushevë, ishin projekte për mbështetjen e iniciativave zhvillimore për përmirësimin e infrastrukturës në ato fshatra.

Edukimi shëndetësor i grave, në organizim të SHQ Flaka, pati për qëllim ngritjen e vetëdijes së grave për gjendjen shëndetësore me qëllim të zvogëlimit të sëmundjeve dhe vdekjes të nënat dhe foshnjat dhe aftësimi i grave nëpërmjet ligjëratave të ndryshme që me kohë të kërkojnë mbrojtje shëndetësore.



➤ Gratë nga bashkësi të ndryshme etnike marrin pjesë në realizimin e projektit

Me urë më afër botës

Fshati Baçkë gjendet në pjesën lindore të komunës së Dragashit, në rrëzën e Malit Sharr, në 1200 metra lartësi mbidetare, 6 km larg qendrës së komunës. Fshati ka rreth 150 shtëpi. Në këtë moment në fshat gjenden rreth 85 banorë, derisa gjatë periudhës verore për pushimet verore numri rritet në 900 banorë, pasi që pjesa më e madhe prej tyre pas luftës në Kosovë, si dhe për shkaqe ekonomike, janë shpërngulur nga ky fshat. Vetëm një numër i vogël i banorëve nga ky fshat janë të punësuar në komunë. Në fshat ka shkollë në të cilën mësojnë fëmijët nga klasa e parë deri në të katërtën, derisa nxënësit nga klasa e pestë deri në të tetën, mësojnë në shkollën fillore në f. Brod. Profesionit kryesor i banorëve të cilët kanë mbetur të jetojnë në fshat, është blegtoria.

Rruga e vetme që e bashkon fshatin me komunën e Dragashit kalon nëpër Lumin e Brodit, në të cilin gjendet ura e vjetër e dëmtuar (e gjatë 8m), nëpër të cilën nuk mund të kalojnë automjetet.

“Në kurbet shkova në vitin 1952. Kishim ëmbëltore atje. Fshati ynë është i veçuar nga bota. Me meremetimin e urës zgjidhëm shumë probleme. Kjo është diçka e papërshkruar. Shpëtim për ne. Me shqiptarët jetojmë mirë. Gjatë krizës u kemi ndihmuar mjaft. Në fshat ka rreth 900 banorë nëpërmjet verës, ndërsa në dimër mezi tetëdhjetë – më të moshuarit dhe ata që kanë punë këtu. Gati të gjithë nga fshati punojmë në Vojvodinë dhe Serbi”, na tha Murat Shaqiri.

Ujë për banorët e fshatit Kosavë

Fshati Kosavë gjendet në pjesën veriore të komunës së Dragashit, rreth 13 kilometra larg nga qendra e komunës. Deri në fshat kalon rruga e paasfaltuar. Kosava është fshat malor-luginor në rrëzën e Malit Sharr, rreth 1150 metra lartësi mbidetare. Fshati ka 110 familje me rreth 1200 banorë të përhershëm. Banorët e këtij fshati kryesisht merren me blegtori. Rreth 30 banorë nga fshati jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, ndërsa 40 banorë punojnë në komunë ose jashtë saj.

Fshati ka katër lagje dhe secila prej tyre ka furnizim të posaçëm me ujë, por në asnjërën nga lagjet nuk janë të vendosur matës të ujit.

Lagjeja Mejzini-Tertini ka rreth 350 banorë të cilët me vetiniciativë janë organizuar që të ndërtohet rezervuar.

Në fshat nuk kishte ujë, vetëm çezmat e fshatit, ndërsa tani kanë kycje të gjitha shtëpitë. Në këto male ka sasi të mëdha të ujit, vetëm si të shfrytëzohet. Lagjja jonë nuk kishte ujë të mjaftueshëm, e merrim nga lagjet tjera. Për mbajtjen e ujit i angazhoni gratë ose fëmijët. Kur duhej të merret sasi më e madhe, e bënim ne burrat. Por edhe krahas kësaj, nuk kishte sasi të mjaftueshme për të gjitha punët”, na tha Veiz Sherifi, banor i fshatit.

Aktiviteti i QMBN-së ishte në mbështetjen financiare për vendosjen e hidroizolimit dhe suvatimit të rezervuarit të ri, si dhe lidhjen me gypa të rezervuarit me rrjetin ekzistues dhe punë të tjera instaluese.



➤ Ndërtimi i urës zgjodhi disa probleme të banorëve nga fshati Baçkë

FORCIMI I PARTNERËVE NË KOSOVË

Vlerësimi i programit Tranzicioni në Kosovë, ishte i rëndësishëm për përgatitjen dhe fillimin e programit të ri Forcimi i Partnerëve në Kosovë, 2003-2004, i cili në vete përmbante dy komponenta kryesore: Forcimi i kapaciteteve të partnerëve në Kosovë dhe Mbështetja e programeve të partnerëve. Këto dy komponenta ishin përfshirë te të tre partnerët lokal.

Në vlerësimin e programit rekomandohet “të tre OJQ-të që t’i maksimalizojnë resurset e veta të kufizuara njerëzore dhe financiare duhet të zhvillojnë vizione, misionë dhe strategji më të fokusuara. Të lidhura nëpërmjet nevojës për fokus më të madh, të tre OJQ-të duhet të zhvillojnë kornizë afatmesme të planifikimit, i cili do t’i lidhë strategjitë dhe aktivitetet me qëllimet organizative dhe nga e cila do të mund të dalin planet dhe buxhetet vjetore.”

Qendra Kosovare për Zhvillim (QKZH)

Forcimi i kapaciteteve

Qëllimi i projektit ishte zhvillimi institucional dhe forcimi organizativ i personelit dhe strukturave udhëheqëse të organizatës, sipas programit të dalë nga Misioni për vlerësim të nevojave, të zbatuar në janar të vitit 2003, nga këshilltarë të huaj të pavarur. Me projektin u realizuan aktivitetet si: trajnimi i anëtarëve të personelit dhe strukturave udhëheqëse; publikimi i raportit vjetor të organizatës si bazë për transparencë përkundër donatorëve, grupit qëllimor dhe aktorëve tjerë relevantë; vlerësimi i jashtëm i organizatës, për shqyrtimin e relevantes, efektivitetit dhe efikasitetit të organizatës te grupi qëllimor pas zbatimit trevjeçarë të aktiviteteve dhe revizioni vjetor për vitin 2002 dhe 2003 me qëllim që të verifikohet funksionimi i procedurave financiare në organizatë.

Mbështetja e programeve

Qëllimi i projektit ishte të kontribuohet në zhvillimin socio-ekonomik të fermerëve në rajonet rurale.

Aktivitetet u realizuan në pjesën juglindore të Kosovës, ku QMBN ishte aktive në periudhën 1999-2001. Kjo përfshinte rajonin më të gjerë të Gjakovës, Rahovecit, Prizrenit dhe komunës së Dragashit. Disa nga aktivitetet u përqendruan në më shumë rajone me grup specifik përcaktues nga rajonet rurale (nëpërmjet komponentës për bujqësi).

Qendra Kosovare për Zhvillim ishte përgjegjëse për grumbullimin, përgatitjen e informatave të cilat ishin lidhur me sektorin e bujqësisë në rajonet e caktuara, nëpërmjet agrobuletinit “Fermeri”. Buletini përmbante informata për rregullativën, gjendjen momentale dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë, studimi i rasteve (rrëfim të suksesshëm nga rajoni qëllimor), informata të rëndësishme statistikore, këshilla për

bujqit etj. Buletini publikohej një herë në tre muaj, ndërsa distribuohet deri të bujqit dhe OJQ-të tjera. Po ashtu QKZH botoi 5 broshura për prodhime të ndryshme bujqësore, siç janë pemët dhe perimet. Në broshurë u përfshinë informata për të veçantën e prodhimeve, kushtet për prodhimin e tij e tjera, ndërsa për të gjitha këto do të inkuadrohen ekspertë të ndryshëm nga fusha e pemëve dhe perimeve.

U organizuan gjashtë trajnime për shoqatat e fermerëve, të cilët janë formuar me ndihmën e QKZH në vitin e mëparshëm. Trajnimet ishin specifike, të lidhura me nevojat e asociacioneve të fermerëve. Po ashtu QKZH ndau 6 grante për shoqata të ndryshme të fermerëve, të cilët u dedikuan për pajisje teknike.

Përveç trajnimeve, u siguroa edhe ndihmë të drejtpërdrejtë teknike për bujqit, të cilët shprehën interesim për përmirësimin e punës së tyre në ferma. Këtu u përfshinë: këshilla për dokumentacionin e rregullt, evidentimin dhe analizën e prodhimitarisë, zhvillimin e planit të punës etj. U organizuan vizita studimi të shembujve pozitivë, mes prodhuesve të prodhimeve të njëjta në Kosovë.

QKZH financiarisht mbështeti 2 iniciativa lokale në rajonin e Gjakovës (përfaqësues të komunës, këshillave të fshatrave, këshillave në rajonet suburbane etj) për përmirësimin e infrastrukturës publike (shkolla, ambulanca, këndin e lojërave për fëmijë).

Ne Jemi Me Ju (WAWY) Forcimi i kapaciteteve


Qëllimi i projektit ishte zhvillimi institucional dhe forcimi organizativ i personelit dhe strukturave udhëheqëse të organizatës, sipas programit të dalë nga Misioni për vlerësim të nevojave, të zbatuar në janar të këtij viti, nga këshilltarë të pavarur nga vendi.

Aktivitetet përfshinë zbatimin e trajnimeve të anëtarëve të personelit dhe strukturave udhëheqëse; publikimin e raportit vjetor të organizatës si bazë për transparencën përkundër donatorëve, grupit qëllimor dhe aktorëve tjerë relevantë, si dhe revizionin vjetor për vitin 2002 dhe 2003.

Mbështetja e programeve

Qëllimi i projektit është zhvillimi institucional dhe forcimi organizativ i OJQ-ve lokale. Rajoni qëllimor ishte pjesa e Kosovës juglindore, ku QMBN ishte aktive në periudhën 1999-2001. Kjo e përfshiu rajonin më të gjerë të Gjakovës, Rahovecit dhe komunën e Dragashit.

Me projektin u zbatuan tri trajnime për udhëheqje me ciklin e projektit (UCP), si dhe NJJ siguroi këshilla individuale për OJQ-të e tjera gjatë gjithë periudhës së programit. U publikuan tri numra të buletinit të OJQ-ve, të fokusuar në rajonin e Kosovës Juglindore. Ne Jemi Me Ju në këtë periudhë 2003-2004 punoi në katër tema si: koalicionet dhe



➤ Buletini për bujqit

rrjete të OJQ-ve; korniza ligjore për OJQ-të; politika tatimore e cila ka të bëjë me OJQ-të; dhe ngritja e vetëdijes për rolin e sektorit të OJQ-ve. U organizuan punëtori dhe debate të hapura lidhur me këto tema.

Iniciativa e Femrës Kosovare (IFK) Forcimi i kapaciteteve

Qëllimi i projektit ishte zhvillimi institucional dhe forcimi organizativ i personelit dhe strukturave udhëheqëse të organizatës, sipas programit të dalë nga Misioni për vlerësim të nevojave, të zbatuar në janar të këtij viti, nga këshilltarë të pavarur nga vendi.

Iniciativa e Femrës Kosovare, zbatoi trajnim për anëtarët e personelit dhe strukturave udhëheqëse, sipas planit për ndërtimin e kapaciteteve; publikimi i raportit vjetor të organizatës si bazë për transparencën përkundër donatorëve, grupit qëllimor dhe aktorëve tjerë relevantë; revizioni vjetor për vitin 2002 dhe raporti i gjysëmvetorit për vitin 2003, nga shtëpia e jashtme revizore, me qëllim që të verifikohet funksionimi i procedurave financiare në organizatë; si dhe revizioni vjetor për vitin 2003, i cili u zbatua në mars të vitit 2004.

Mbështetja e programeve

Kjo komponentë u zbatua nga partneri lokal IFK. Qëllimi i projektit ishte zhvillimi i shoqërisë civile me fokus të çështjes së femrës.

Aktivitetet u zbatuan në pjesën juglindore të Kosovës, ku QMBN ishte aktive në periudhën 1999-2001. Kjo e përfshiu rajonin më të gjerë të Gjakovës, Rahovecit, Prizrenit dhe komunës së Dragashit. Disa nga aktivitetet u përqendruan në më shumë rajone me grup specifik të përcaktuar.

Në kuadër të projektit u mbështetën gjashtë debate për ngritjen e vetëdijes publike, për rolin e femrës në proceset shoqërore. U realizuan dy trajnime për forcimin e kapaciteteve të grupeve të femrave, dy trajnime për pushtetin lokal, një trajnim për administratën publike, një trajnim për marrëdhënie me opinionin dhe gjashtë punëtori për grupin e përcaktuar.

Mbështetja e Iniciativës së Femrës Kosovare u stopua në vitin 2004, për shkak të ndryshimeve të brendshme strukturore në organizatë dhe ndarja në dy subjekte të pavarura, Iniciativa e Femrës Kosovare dhe Iniciativa e Femrës Kosovare – Vizioni i Ri.



➤ **Mirënjohje për QMBN-në nga partnerët kosovarë**

NË KOSOVË NA MBAJ- NË MEND PËR TË MIRË

Kujtime nga Kosova



Puna në Kosovë ishte një nga episodet më me përshtypje në jetën time.

Vendimin që ta pranojë sfidën, në gusht të vitit 1999, e mendoja gjatë kohë, e me siguri momenti kryesor që solli deri te kjo, ndodhi pesë muaj më parë, në fillim të bombardimeve të NATO-s ndaj RF të Jugosllavisë. Kjo ndodhi në ditëlindjen e ndonjërit nga fëmijët e shokëve të mi nga shkolla e mesme, ku për herë të parë me ata bisedonim për krizën e atëhershme – vetë bombardimin, përparësinë e intervenimit, situatën me refugjatët në Bllacë, marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, pasqyrën/stereotipat për shqiptarët “tanë”. U befasona (thënë butë) nga dallimet në diskutimet, qëndrimet, por edhe në vetë terminologjinë, mes meje dhe miqve të mi. Vëreja se përvoja pesëvjeçare në QMBN dhe mundësia që të punohet me shumë grupe të ndryshme të njerëzve (mjedise etnikisht të përziera; rurale/urbane; promotorë të drejtave të grupeve të marginalizuara – romëve, grave dhe skeptikëve rreth këtyre çështjeve) dukshëm e rriti tolerancën time të dallimeve dhe aftësia t’i kuptoj dhe t’i pranoj “të tjerët”. Atëherë kuptova se dëshiroj dhe duhet të vazhdoj në këtë drejtim, dhe se me përvojën e fituar, mund të kontribuojë në tejkalimin e dallimeve në kuptimin mes grupeve të ndryshme.

E mbaj mend gjendjen në Kosovë në vjeshtën e vitit 1999. Duke filluar nga shmangja e vrimave të shkaktuara nga bombardimet e NATO-s, veç më të rrugëve të shkatërruara, në të cilat asnjëherë nuk është investuar që kur janë ndërtuar. Ose, udhëtimet e gjata nëpër rrugët e tilla dhe pritja e urëve të përkohshme dhe të vendkalimeve kufitare. Pastaj, përdorimi i telefonave satelitor, si mënyra e vetme e mundshme e komunikimit, pas përfundimit me kushtet e punës në zyrat dhe vendbanimet – shpesh pa ujë dhe rrymë, me gjeneratorë të zëshëm me benzinë dhe me koftorë të drurit, që të neutralizohet temperatura prej -20 gradë celsius.

Situata e tillë veç më ishte mjaft “avanturiste”, por edhe nëpër vetë punën pati shumë sfida. Për mua pjesërisht paraqiste shok kulturor edhe vetë udhëtimi i parë në Kosovë, kur prisja të dominojnë simbolet etnike shqiptare dhe ato religjioze myslimane, ndërsa e pashë kishën ortodokse të ndriçuar në qendër të Prizrenit. Ose, vozitja nëpër rrugën kryesore – “korzonë” e Gjakovës, plotë me të rinj, të veshur me rroba moderne, djem e vajza, pa kurrfarë gjurma nga rregullat tradicionale fetare të veshjes.

Pati sfida edhe nga karakteri i sigurisë – kërcënime me telefon deri te disa kolegë të mi, si dhe hyrja e personave të armatosur në zyrat tona. Megjithatë, përfaqësuesit e komunës dhe policisë lokale me sukses u ballafaquan me ata. Mua, përshtypje më lanë edhe vizitat e enklavave serbe në Rahovec, Shtërpçë ose Graçanicë, me mundësi të realizoj komunikim nga të dy anët e barrikadave të sigurisë të forcave të NATO-s dhe të kontribuoj për vendosjen e lidhjeve të ndërprera mes fqinjëve dhe miqve të dikurshëm.

Më kujtohet edhe zjarri në sallën sportive “Boro dhe Ramizi” në Prishtinë, si dhe pastaj “humori i zi” – nëse është djegur pjesa e Boros ose e Ramizit? Unë kisha një rrëfim të ngjashëm – kur një punëtor humanitar britanik, publikoi një tekst në internet “Cikleja dhe Fatmiri”, duke e potencuar bashkëpunimin tim si maqedonas etnik me kolegun – shqiptar etnik.

Përshtypje më la edhe deklarata e nikoqirit tonë në shtëpinë që e kishim me qira në Gjakovë – Agron Poloshka, pas diskutimit rreth rrugës së Maqedonisë drejt pavarësisë dhe tërheqja e gjithë armatimit të armatës jugosllave, kur tha “duhet t’i ndërtoni përmendore prej 30 metrove, që kaluat nëpër këtë pa luftë”.

Diskutimet në Kosovë në temën varësi – pavarësi, u konkretizua në vitin 2001, kur QMBN vendosi ta mbyllë zyrën e vet operative dhe të vazhdojë me mbështetjen e tre organizatave lokale. Ne e përsheptuam pavarësinë e tyre, ndërsa (për befasinë time) ata preferonin “varësi” nga QMBN-ja. Në fund erdhëm deri te kombinimi më i mirë – ndërvarësi, ku si partnerë të barabartë dhe tani bashkëpunojmë në aktivitete nga interesi i përbashkët.

Po, këto ishin disa nga kujtimet dhe përvoja ime, nga koha e operacionit të madh humanitar kur QMBN, bashkë me 300 organizata të tjera ndërkombëtare dha kontribut për përtëritjen e Kosovës.

Koha kur me angazhim intensiv, në periudhë të shkurtë kohore dhe kushte të vështira, u ndihmuam 350 familjeve që t’i rindërtojnë shtëpitë, disa mijëra persona të ushqehen gjatë dimrit të parë pas luftës, kryesisht – shtatë fshatra me banorët e vet ta përtërisin jetën e vet.

Pse e bëjmë gjithë këtë?

Lexoni në rrëfimin e Alekut.

Aleksandar Kërzhallovi,
*koordinatori i programeve të QMBN-së
në Kosovë në periudhën 1999-2001*



Punë me shumë peripeci

Fundi i vitit 2001 më solli para një vendimi interesant, të paraqitem ose jo për punë në Kosovë, si përfaqësues i QMBN-së në Kosovë. Ishte shumë nxitëse që të paraqitem, por në të njëjtën kohë edhe dilemë nëse koha e kaluar atje me organizatat partnere do të jetë produktive dhe do të jetë e begatshme. Megjithatë u paraqita, kjo për mua ishte angazhim plotësues, dhe me shumë energji. Një punë ishte e qartë, se atë që përpiqemi ta bëjmë për zhvillimin e kapaciteteve të tre partnerëve tanë lokal, është vetëm një investim i yni i vogël në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Puna në fillim ishte si t'ia nisish të kujdesesh për foshnjën ose për adoleshentin, mendimi se i dinë të tëra dhe se nuk u duhet ndihmë. Kjo e bënte punën edhe më sfiduese, për mua dhe kolegët tjerë të kyçur nga QMBN-ja. E kujtoj momentin kur flisja me tre partnerët lokalë për nevojën nga planet strategjike dhe mendimet për ndryshime, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të luftosh me sfidat e reja të cilat paraqiten. Ju dukej se u flasim për diçka që është larg nga nevojat e tyre. Pas një viti jo të plotë, dy nga tri organizatat filluan të flasin në këtë temë, filluan të mendojnë në mënyrë strategjike për orientimin e tyre të mëtejshëm. Ne nga QMBN-ja ishim atje që t'u ndihmojmë, t'u ndihmojmë me përvojën tonë në gjetjen e rrugës, e cila ata dhe grupet e tyre qëllimore do t'i kënaqte. Tani të tri partnerët lokal janë organizata të njohura, në fusha të ndryshme të veprimit. QKZH në fushën e bujqësisë, NJJ – në zhvillimin e shoqërisë civile nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OQ dhe institucioneve të vetëqeverisjes lokale, ndërsa partneri i tretë IFK e cila pas ndryshimeve të brendshme strukturore u nda në IFK dhe IFK- Vizioni i ri janë të njohura në zgjidhjen e problemeve lidhur me çështjet gjinore.

Fatmir Bytyqi

*koordinatori i programeve të QMBN-së
në Kosovë në periudhën 2002-2004*



➤ Aleksandari me banorët e fshatit Baçkë, Dragash

Rrëfimi i Alekut

Me lojën e fatit para pesë vjet e gjysmë u punësova në QMBN. Angazhimi im i parë ishte më 5 gusht të vitit 1999 në Kosovë, në qytetin e Gjakovës.

Gati të gjithë kolegët e mi, miqtë dhe kushërinjtë, vendimin tim që të shkoj atje e komentonin si jo të shëndoshë. Dorën në zemër në një moment fillova të dyshoj edhe vetë, por megjithatë shkova. Normalisht me frikë.

Kur arrita atje na priste shumë punë, e nuk kisha kohë ta rishqyrtoj vendimin tim. Bashkëpunëtorët e mi ishin shqiptarë. Kolegët e mi ishin shqiptarë. Shfrytëzuesit e ndihmave që e distribuonim ishin shqiptarë. Në fillim isha një nga dy e krishterët ortodoks në Gjakovë.

Pas dy viteve, shkova në enklavën serbe Shtërpçë. Bashkëpunëtorët e mi ishin serbë, shfrytëzuesit e ndihmave që e distribuonim ishin serbë.

Në vitin 2001 u ktheva në Maqedoni. Edhe neve na gjeti fati i njëjtë. Filloi konflikti i armatosur. Punoja me personat e zhvendosur brenda vendit – maqedonas. Bashkëpunëtorët e mi ishin maqedonas, shfrytëzuesit e fundit të ndihmës që e distribuonim ishin maqedonas.

Në këto pesë-gjashtë vite punova edhe me shqiptarë edhe me maqedonas edhe me serbë. Fizionomitë e tyre ndryshonin, religjioni i tyre ishte i ndryshëm, por mundimet e tyre ishin të njëjta. Thonë, as vëllezërit nuk janë të njëjtë, as gishtat e duarve nuk janë të njëjta, por këta njerëz ishin të njëjtë.

Atje isha përfaqësues i QMBN-së ose si në Kosovë na quanin QMBN, ose “baca Alek prej QMBN-së”.

Këto ditë me kolegët nga departamenti i informatave përsëri isha në Kosovë. Kur arritëm atje nuk e dija si do të na pranojnë, por dyshimet u zhdukën. Të gjithëve, u kujtohej dhe na mbanin mend për të mirë. Me fytyra të buzëqeshura flisnin për QMBN-në.

Nuk mund ta përshkruaj ndjenjën që më kaploi në ato çaste. Ndjenjë që e kaplon njeriun kur i sheh rezultatet pozitive nga ajo që e ka punuar.

Mendoj se ne, QMBN, ua zgjatëm jetën të gjithë atyre njerëzve që mundoheshin dhe atë në momentet më të vështira. Besoj se e kanë pasur vështirë kur është dashur t'i braktisin shtëpitë e tyre, por edhe më vështirë kur njeriu kthehet dhe duhet të bëjë diçka nga ajo që ka mbetur nga shtëpia e tij, të cilën e ka ndërtuar gjithë jetën e tij.

I përshëndes të gjithë ata të cilët kishin nevojë nga ndihma jonë, të gjithë ata të cilëve u ndihmuam, të gjithë ata që na mbajnë mend ose veç më me kohën na kanë harruar, dhe të gjithë ata që flisnin fjalë të mira për ne.

Të jenë shëndoshë e mire, dhe të mos dhëntë Zoti përsëri të keni nevojë nga ndihma e tillë nga ana jonë. Mbetshi me shëndet.

Aleksandar Stevanovski,

bashkëpunëtor i projekteve në QMBN

TË DHËNA STATISTIKORE

QMBN arritjet e veta i ndjek me sistemin për vëzhgim të portfolios së projekteve, si dhe me evidenca specifike për prodhimet individuale.

Ndjekjen e portfolios projekteve QMBN e bënë nëpërmjet disa parametrave: sektori, programi, lokacioni, grupi qëllimor dhe instrumenti. Në këtë pasqyrë janë dhënë rezultatet sipas disa parametrave, në pasqyrën tabelore sipas viteve. QMBN në punën pesëvjeçare në Kosovë realizoi 120 projekte, me buxhet prej 485 milionë denarë ose rreth 7 milionë euro. Në tabelën numër një janë dhënë projektet e realizuara sipas sektorëve dhe viteve. Mbi 50 për qind të projekteve të realizuara janë në shoqërinë civile, pastaj bujqësia, ndihma urgjente etj.

Tabela 1

Numri i projekteve sipas sektorëve në periudhën 1999-2004

Sektori	1999	2000	2001	2002	2003	2004	Gjithsej
Furnizimi me ujë dhe sanimi		1		3	2		6
Punësimi dhe gjenerimi i të ardhurave	1						1
Shoqëria civile dhe demokracia	11	17	3	27	5	1	64
Ndihma urgjente	11	2					13
Bujqësia	5	8	2	10	1		26
Aktivitetet sociale	2	4		4			10
Gjithsej:	30	32	5	44	8	1	120

Instrumenti i përdorur dominant në programet në Kosovë, por edhe në përgjithësi në QMBN është mbështetja financiare.

Tabela 2

Numri i projekteve sipas instrumenteve në periudhën 1999-2004

Instrumenti	1999	2000	2001	2002	2003	2004	Gjithsej
Mbështetja financiare	26	22	5	12	8		73
Huazimi							
Trajnimit	2	8		20			30
Informatat	2			6		1	9
Përfaqësimi/lobimi		2		6			8
Gjithsej:	30	32	5	44	8	1	120

34

Grupi qëllimor	1999	2000	2001	2002	2003	2004	Gjithsej
Gratë	1	3		8	1		13
Fshatarët		7			1		8
Pakicat etnike		2		2	2		6
Fëmijët dhe të rinjtë	3	1					4
Grupet e marginalizuara		4					4
Refugjatë dhe persona të zhvendosur	15	1	2	10			28
E përgjithshme	11	14	3	24	4	1	57
Gjithsej:	30	32	5	44	8	1	120

Tabela 3

Numri i projekteve sipas grupit qëllimor në periudhën 1999-2004

Shpërndarja sipas grupit qëllimor është bërë në kategoritë e cekura sipas pjesëmarrjes dominante të shfrytëzuesve në projektet. Në rastet kur prezenca e shumëfishtë (pjesëmarrja në dy ose më shumë kategori të cekura, për shembull të femra të reja gorane në mjedise rurale) e shfrytëzuesve, është llogaritur vetëm njëra, më e qëlluara në krahasim me numrin e shfrytëzuesve dhe llojin e aktivitetit të projektit.

RAPORTI FINANCIAR

GJITHSEJT	1999	2000	2001	2002	2003	2004	Total
Interchurch Organisation for Development Cooperation	5,436,607	155,245,149	3,250,000	20,675,500	21,612,175		176,983,277*
Dutch Interchurch Aid	71,704,717	6,964,356					78,669,073
ACT Netherlands		3,999,485	13,461,211				17,460,696
Christian Aid	26,911,499	19,591,165					46,502,664
Norwegian Church Aid	20,353,035						20,353,035
DanChurchAid		931,001	12,321,033				13,252,034
Swiss Interchurch Aid	2,379,229	12,093,738					14,472,967
Diakonisches Werk	7,751,070			3,052,275			10,803,345
Lutheran World Relief	14,281,828	18,875,937					33,157,765
Lutheran World Federation	6,407,134						6,407,134
United Church of Canada	811,642						811,642
Presbyterian Church	23,944,012						23,944,012
United Church of Christ Japan	1,692,371						1,692,371
Regional Environmental Center		550,664					550,664
Të ardhura personale dhe të tjera	4,957,026	4,497,822			345,666	3,859,491	13,660,005
GJITHSEJT TË ARDHURA	186,630,170	222,749,317	29,032,244	23,727,775	21,957,841	3,859,491	458,720,684
SHPENZIME							
Rikonstruimi i shtëpive	66,197,990	66,492,522					132,690,512
Infrastruktura publike	2,120,708	1,434,856					3,555,564
Aktivite sociale	8,912,488	8,440,439					17,352,927
Distribuimi i ushqimit	47,996,550						47,996,550
Ndihmë bujqësisë	22,977,572	64,817,615	18,437,916				106,233,103
Gjenerimi i të ardhurave	3,689,183						3,689,183
Zhvillimi i shoqërisë civile	1,948,191	4,619,245	2,707,467	15,742,136	19,940,351	493,730	45,451,120
Mediumet dhe informatat	4,408,696	2,292,012					6,700,708
Aktivite rezervë (kontigjente)	4,617,619						4,617,619
Mbështetje logjistike	6,579,005						6,579,005
Gjithsejt ndihmë direkte	169,448,002	148,096,689	21,145,383	15,742,136	19,940,351	493,730	374,866,291
Shpenzime operative	17,265,120	45,416,474	8,929,692	7,156,126	3,608,680	673,610	83,049,702
GJITHSEJT SHPENZIME	186,713,122	193,513,163	30,075,075	22,898,262	23,549,031	1,167,340	457,915,993
BILANCI	-82,952	29,236,154*	-1,042,831	829,513	-1,591,190	2,692,151	804,692

* Bilanci në vitin 2000, del nga ICCO dhe është shfrytëzuar për financimin e programeve në Kosovë në vitet e ardhshme. Distribuimi i mjeteve sipas viteve është mbajtur në tabelë, por shuma e përgjithsme nga ICCO është zvogëluar për atë shumë.

ORGANIZATA

QMBN-ja është themeluar më 14 dhjetor të vitit 1993. Shtatë themelues dhe tre anëtarë tjerë e përbënin Këshillin e parë ekzekutiv, me mandat prej një viti, kur edhe është vendosë struktura drejtuese dhe udhëheqëse e QMBN-së: Kuvendi, Këshilli ekzekutiv dhe Shërbimi profesional, e udhëhequr nga program-drejtori. Regjistrimi i QMBN-së është bërë në vitin 1994.

KUVENDI/KËSHILLI

Organi më i lartë udhëheqës i QMBN-së është Kuvendi/Këshilli. Këshilli i ka këto përgjegjësi: aprovon politikën dhe strategjinë e përgjithshme; aprovon raportin vjetor me revidim; zgjedhën anëtarë të Këshillit udhëheqës; vendos për bashkimin me fondacion tjetër dhe anëtarësimin e QMBN-së në organizata dhe lidhje vendase apo ndërkombëtare; realizon edhe punë tjera në pajtim me Statutin dhe me aktet e përgjithshme të QMBN-së.

KËSHILLI EKZEKUTIV/DREJTUES

Anëtarët e Kuvendit/Këshillit e zgjedhin Këshillin ekzekutiv/drejtues i cili përbëhet nga 10 anëtarë. Gjithsej 19 persona kanë qenë anëtarë të Këshillit në periudhën prej vitit 1993-2003. Këshilli drejtues i QMBN-së aprovon programe dhe plane vjetore; aprovon plane financiare; aprovon llogarinë vjetore; sjell vendim për mjetet e QMBN-së në kuadër të planit financiar; sjell vendim për dhënien e dhuratave ; sjellë akte me të cilat rregullohet puna e Zyrës ekzekutive; e emëron Drejtorin ekzekutiv; themelon shoqata tregtare.

Përbërja e Këshillit drejtues në periudhën 1998-2004

Mirko Spiroski
Ivan Tulevski
Natasha Gaber – Damjanovska
Teuta Krashnica – Çukçkova
Dragi Kostadinovski
Zejnulla Fazliu
Zoran Kostov
Mihail Cekov
Muhamet Toçi
Nurie Kadriu
Bukurie Bajrami
Biljana Gerasimovska – Kitanovska
Sveto Stefanovski

ZYRA EKZEKUTIVE

Më poshtë është dhënë personeli i cili drejtpërdrejtë ka qenë i angazhuar gjatë krizës me refugjatë në Maqedoni dhe zyra e QMBN-së në Gjakovë dhe Dragash, të cilët kanë qenë të angazhuar si personel lokal.

Zyra ekzekutive e QMBN-së:

Drejtor akzekutiv

Sasho Klekovski

Zhvillim

Roman Papadimitrov

Aco Kočovski, Dimçe Mitreski

Lupço Kočovski, Mirjana Fotevska

Nikola Ikonov, Vladimir Lazovski

Nahida Zekirova, Aleksandar Gumberovski

Aleksandar Jovanovski

Operacionet e emergjencës 1999

Albert Hani, Aleksandar Qurçiev

Elisaveta Bejkova, Goce Solev

Goran Velkovski, Sinisha Stojkoski

Kostadin Gramatikov

Punësim

Tetjana Lazarevska

Joana Josifovska, Emina Mahmutoviq

Hamsi Behluli, Lara Krsteva-Içokaeva

Lupço Toshev, Vasil Minovski

Vlatko Danilov, Lazar Nedanoski

Afrodita Musliu, Sonja Jovanovska

Lirim Hajredini

Shoqëria civile

Lucia Popovska

Sunçica Sazdovska, Valentina Çiçeva

Goran Buldioski, Liljana Alçeva-Jovanovska

Fatmir Bytyqi, Kalin Babushku

Neda Maleska Saçmaroska, Aleksandar Stamboliev

Kushtrim Hoxha, Florent Bajrami

Emina Nuredinoska, Krenar Kuka

Programe urgjente dhe ndërkombëtare

Aleksandar Kërzhalovski

Aleksandar Stevanovski, Salih Alili

Gjergj Tane, Tahir Nuhi

Tanja Hafner, Dervisha Haxhiq

Miodrag Koliq

Informata

Gonce Jakovleska

Aneta Trajkovska, Daniel Medaroski

Jane Stefanov, Kreshnik Ajdini

Darko Dimitrovski, Suzan Shaqir – Sulejmani

Gramoz Shabani, Filip Stojanovski

Daniela Stojanovska, Adis Rahiq

Administrata dhe financat

Aleksandar Buzharovski

Toni Gicev, Vesna Bogdanovska

Danilo Mitov, Marjan Dimitrov

Mirjana Kunovska, Milka Miova-Bozhinovska

Biljana Vuçureviq

Zyrat në Gjakovë dhe Dragash

Eranda Kumnova

Rajmonda Purini

Ismet Isufi

Ardita Rizvanoli

Avni Kasumaj

Kushtrim Kuqi

Mevlije Dafota

Leonora Kuludra

Petrit Zrza

Ylli Bardi

Albert Dafota

Vegim Nura

Astrit Dafota

Husein Ismaili

Avdi Ferizi

Edmond Kuludra

Arbana Zhara

Bujar Bunari

Afrim Rudi

Seat Nuhiu

KANË THËNË PËR NE

Për ta përshkruar QMBN-në, ndoshta është më mirë të prezantohet çka kanë thënë tjerët për QMBN-në: vlerësues, partnerë dhe bashkëpunëtorë.

VLERËSIME TË PROGRAMEVE NË KOSOVË

Vlerësime të programeve të ACT-it në Kosovë (2000-2002)

QMBN-ja morri pjesë edhe në tre vlerësime të ACT-it, për operacionet në Maqedoni dhe në Kosovë nga viti 1999 deri në vitin 2001. Njohuritë kryesore sa i përket QMBN-së ishin: inovacion në dizajnin e përkrahjes dhe e vetme me shembullin e vet pozitiv për bashkëpunimin e mundshëm të njerëzve me prejardhje të ndryshme etnike dhe fetare në kontekstin ballkanik.

Prania e QMBN-së në Kosovë ishte sfidë në vete. Siç theksoi një vlerësues i programeve të ACT-it në Kosovë, ekipi për vlerësim ishte i impresionuar me faktin se mysliman slloven (Goran) në rajonin e largët të Dragashit ndihmohen nga QMBN-ja (kryesisht ortodoks të punësuar në personelin në Shkup) me personel lokal i përbërë nga shqiptarë etnik. Me angazhimin e vet QMBN-ja dha shembull për bashkëpunimin rajonal fqinjësor.

Tranzicioni në Kosovë (TKS), Mokoro (Britania e Madhe), viti 2002

QMBN-ja arriti të ndihmon tre OJQ-ve të inkorporojnë disa nga elementet përbërëse për menaxhim efikas – struktura përgjegjëse, menaxhim efikas financiar, kapacitet raportues, rutina për ruajtjen e dokumentacionit. Nevojitet qasje profesionale për zhvillimin e kapacitetit të çdo organizate në veçanti.

PARTNERËT LOKALË

“Në muajin gusht të vitit 1999 në kabinetin tim, si kryetar i atëhershëm i Kuvendit të komunës së Gjakovës, i pritja përfaqësuesit e QMBN-së. Në fillim isha pak skeptik sepse shumë organizata premtonin ndihmë emergjente. U propozova ta ndihmojnë rikonstrukcionin e shtëpive në fshatrat Shqiponja, Smolica dhe Ponoçeci, të shkatërruara nga lufta. Qasja në realizimin e këtyre projekteve ishte shumë serioze nga ana e QMBN-së dhe para se të arrijë dimri këto projekte u realizuan me kushtim të madh nga ana e të punësuarve të QMBN-së. Më ka ngelë në kujtesë angazhimi i QMBN-së në përkrahjen financiare të qumështores “Golaj”. Si ndërmarrje ajo hapi perspektivë dhe i ktheu shpresat e këtyre fshatrave. Në ato ditë të rënda QMBN-n do ta kujtojmë si një partnerë të respektuar”.

Mazlom Kumnova, ish kryetari i Kuvendit të komunës së Gjakovës

“QMBN-ja është organizatë mjaft e njohur në Kosovë dhe ajo do të mbahet mend për çdo herë. Në periudhën më të rëndë në të cilën kalonte Kosova, QMBN-ja ishte thellë e kyçur për të ndihmuar. QMBN-ja dhe anëtarët e saj ishin shumë të angazhuar të ndihmojnë në tërë rajonin. Angazhimet e tyre ishin të ndryshëm, atë që e kanë bërë ata në veçanti i përket të ashtuquajturës fazë emergjente. Angazhimet ishin të karakterit të ndryshëm por shumë të rëndësishme.

Në rast se ndokush kalon në këtë rajon, ai çdo kund do ti vëren gjurmët që i ka lënë QMBN-ja. Gjurmët nuk kanë vetëm domethënie simbolike dhe materiale. Shumë më i madh është ndikimi në ndjenjat dhe mendimet e njerëzve. Thjeshtë edhe nëse pyetet një njeri ordinar për QMBN-n, ai do tu tregoj shumë për QMBN-n. Fjalët e njerëzve pothuaj çdo herë do të jenë të njëjta: faleminderit QMBN.

Duke punuar si anëtar i personelit lokal në Gjakovë kisha mundësi jo vetëm të punoj dhe ti plotësoj obligimet e mia por edhe të arrijë shumë më shumë.

Sasho, Aleksandri, Fatmiri dhe të punësuarit tjerë në QMBN, përpos investimeve dhe ndihmës të cilën e mundësonin, ata gjithashtu investonin edhe në njerëz. Ata filluan të na trajnojnë në tema të ndryshme në veçanti në lëmin e “shoqërisë civile”.

Si rezultat i kësaj QZK-ja është njëra nga organizatat më të suksesshme joqeveritare në Kosovë. Gjithçka filloi me themelimin e QZK-së me grand nga QMBN-ja. Në vazhdim vijoi një zhvillim i shpejtë. QZK-ja ndihmoheshe në mënyrë permanente dhe arriti në nivelin në të cilën është sot.

E shfrytëzoj këtë mundësi e cila rastësisht përputhet me mbarimin e vitit, ti shprehi urimet e mia për 5-vjetorin e pranisë së QMBN-së në Kosovë me dëshirë për sukses të madh.

QMBN-ja është organizatë ndërkombëtare e cila ka rol të madh në zhvillimin e mëtutjeshëm të rajonit dhe Evropës. Shpresojmë se në këto procese QZK-ja do të jetë së bashku me QMBN-n.

Edhe njëherë urime!”

Ismet Isufi, drejtor ekzekutiv i Qendrës Zhvillimore Kosovare (QZK)





“Në fillim kur QMBN-ja filloi me aktivitetet e saj në Kosovë ishim një grup i vogël njerëzish të cilët arritëm ta koordinojmë punën mirë. Kishim marrëdhënie të mira me personelin ndërkombëtar edhe pse ata ishin maqedonas. Në fillim ishte rëndë mirëpo me punë arritëm që ti tejkalojmë këto barriera. QNMB-ja në atë kohë filloi me zhvillimin e kapacitetit të personelit lokal. QMBN-ja kishte besim te na kur na lejoji të menaxhojmë me projektet. Si rezultat i kësaj u lind ideja për themelimin e një organizate. Tani pas gjithë këtyre viteve punë në projekte të ndryshme mendoj se e kemi përmirësuar administrimin. Si personel mësuam si ta bëjmë mbikëqyrjen dhe vlerësimin e projekteve. QMBN-ja na ndihmoi në ndërtimin e urave me donatorë tjerë. Mësuam të komunikojmë me pushtetin lokal. Ne jemi një organizatë e re, mirëpo fituam përvojë të madhe për një periudhë të shkurtë.”

Ardita Rizvanoli, kryetare e Iniciativës Kosovare të Guas – Vizion i ri

“Bashkëpunimi me QMBN-n filloi në shtator të vitit 1999. Në dhjetor e realizuam projektin e parë me QMBN-n. Në vitin 2002 u vendos që organizata “Ne jemi me Ju” të jetë partner i QMBN-së në lëmit e shoqërisë civile. Në kuadër të programit realizuam aktivitete siç janë trajnimet, lobime, transparencë e organizatave qytetare në publik. Në pesë vitet e kaluara QMBN-ja u bë një organizatë mjaft e njohur në Kosovë. Edhe ne arritëm të krijojmë besim te tjerët. Urime ditëlindjen dhe shumë suksese në të ardhmen.”

Luan Gola, program menaxher në “Ne jemi me Ju”

“Në gusht të vitit 1999 filluan aktivitetet me të cilat QMBN-ja i analizonte komunat në të cilat mundet të kyçet. Rajoni i Dukagjinit kishte pësuar dëme të mëdha. Atëherë QMBN-ja vendosi që selia e zyrës të jetë në Gjakovë dhe ti mbulon komunat Gjakovë, Prizren, Deçan. Faza e dytë ishte rikonstruksioni i shtëpive të dëmtuara. Ndihmë u dha edhe në bujqësi dhe në shoqërinë civile. Kishte një bashkëpunim të madh me institucionet lokale dhe ndërkombëtare. Dituritë themelore i morëm nga QMBN-ja si edhe nga trajnimet dhe përvoja e punës. QMBN-ja është organizatë e madhe jo vetëm në Maqedoni por edhe në rajon. Mësime e mësuara nga puna me QMBN-n do ti realizojmë në të ardhmen. Edhe pse tani jemi pavarësuar si organizatë ne vazhduam aktivitetet e njëjta. Ju faleminderit për gjithçka që bëtë për ne.”

Eranda Kumnova, kryetare e Iniciativës Kosovare të Guas



"QMBN-ja ishte e pranishme në Dragash menjëherë pas mbarimit të luftës në vitin 1999. Bashkëpunimi me përfaqësuesit e saj ishte shumë i hapur, miqësor dhe me mirëkuptim. Ishte shumë këndshëm të bashkëpunohet me Nikollën dhe Gjergjin. Jemi falënderues dhe do të na ngelën në kujtesë fakti se na ndihmuat në momentet më të rënda. Ju dëshiroj shumë sukses në punën e mëtutjeshme dhe festim të pasur të pesë vjetorit të cilin shumë do tu a kishin zili."

Irfan Ibrahim, Kuvendi i Komunës së Dragashit

"Në momentet kur në Industrinë për materiale ndërtimore në Gjakovë bënim orvatje të mëdha për aktivimin e fabrikës kishte shumë premtime nga organizata të ndryshme nga jashtë, mirëpo premtimi i QMBN-së për ndihmë u realizua shpejtë dhe në mënyrë efikase me çka u plotësuan nevojat themelore për aktivimin e fabrikës. Gjegjësisht filloi prodhimtaria në kohë kur kërkesa për materiale ndërtimore ishte e madhe në Kosovë pas luftës. Në pesë vitet e kaluara e rritëm kapacitetin e prodhimit dhe me këtë edhe kualitetin e përdorimit të metodave bashkëkohore në shitjen e prodhimeve tona. Ju faleminderit për kontributin tuaj dhe për at që e arritëm me ndihmën tuaj".

Oliver Curi, drejtor i IGM-së

"Organizata jonë punon në rajonin e komunës së Shtërpçes prej vitit 2000. Në periudhën pas luftës në Kosovë dhe që nga ekzistimi i organizatës sonë deri sot në këto hapësira nuk janë paraqitur organizata si QMBN-ja, si nga mënyra e punës ashtu edhe nga ndihma të cilën e kanë dhënë."

E vetmja gjë që është shfaqur mbas luftës është prania e QMBN-së. Ajo ishte organizata e vetme e cila nga ne kërkoi dhe na ofroi bashkëpunim. Atë që e bëri QMBN-ja për 13 fshatrat tona në komunën e Shtërpçes mendoj se edhe ne vetë nuk do ta na kujtoheshe ta bëjmë më mirë. Në emër të organizatës dhe në emër të gjithë banorëve të komunës sonë dëshirojmë ti falënderohemi QMBN-së për ndihmën e dhënë. Jemi të kënaqur që kishim një partner të tillë, i cili nëpërmjet punës humanitare na ndihmoi shumë të mësojmë. Edhe sot të moshuarit dhe të rinjtë flasin për QMBN-n, për Alekun, njeriu i cili punoi së bashku me banorët në kushtet më të rënda kohore. Zoti le ta ruan QMBN-n dhe të gjithë të punësuarit e saj".

Miroslav Milosavgeviq, nënkryetar i organizatës qytetare "Jetë më e mirë", Shtërpçe

"Komuna jonë në periudhën pas konfliktit të vitit 1999 ishte në gjendje shumë të rëndë. Ndihma e cila arriti nga Maqedonia na befaso i të gjithëve, ajo ishte një gjë të cilën nuk do ta harrojmë asnjëherë. Prania e saj në komunën e Dragagashit ndryshoi shumë gjëra në jetën tonë. Deri në paraqitjen e saj nuk kishim dëgjuar asgjë, mirëpo pastaj kuptuam se ka strehuar shumë refugjat nga Kosova. Nuk do ta harrojmë ndihmën e distribuuar humanitare, ndërtimin e ujësjellësit në fshatin tona si edhe shumë aktivitete tjera. Ju faleminderit për zëmbëritë."

Nuhija Tahirovci, komuna e Zlipotokut



Botues

Qendra Maqedonase për
Bashkëpunim Ndërkombëtar

**Drejtor ekzekutiv i QMBN dhe
redaktor përgjegjës**

Sasho Klekovski

Redaktor

Gramoz Shabani

**Për monografinë
kontribuan**

Gonce Jakovelska
Aleksandar Kërzhlovski
Fatmir Bytyqi

Disejri

Koma, Shkup

Shtypi

Boro Grafika, Shkup

Tirazhi

600 kopje

Adresa

Qendra Maqedonase për
Bashkëpunim Ndërkombëtar
rr. "Nikola Parapunov" p.n.,
f.p. 55 1060 Shkup
Republika e Maqedonisë
e-mail: mcms@mcms.org.mk

www.mcms.org.mk

www.graganskisvet.org.mk

CIP – Katalogizim në publikim

Biblioteka popullore dhe universitare "Shën Klimenti i Ohrit",

341.232:061 (497.7) (497.115) "1999/2004"

5 vjet QMBN në Kosovë : 1999-2004 / (redaktor përgjegjës
Sasho Klekovski ; redaktor Gramoz Shabani). – Shkup : Qendra
Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN), 2005.
– f.44. : ilustrime me ngjyra ; 20 cm

ISBN 9989-102-18-X (MCMS)

1. Ballina

a) Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar – Kosova
– 1994-2004

COBISS.MK-ID 63065866

